



Zu.KM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 771 , datë 15.12.2021

P Ë R

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.587, DATË 22.7.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE
TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT
E REJA PËR ZHVILLIM DHE RINDËRTIM NË TË NJËJTIN
TRUALL", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, shkronja "a", pika 1, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 2.1, shifra "... 4 666 179 207 (katër miliardë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH ..." zëvendësohet me "... 6 526 179 207 (gjashtë miliardë e pesëqind e njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH ...".
 - b) Pika 3.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3.1 Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 6 526 179 207 (gjashtë miliardë e pesëqind e njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë. Efektet financiare, sipas kësaj pike, do të përballohen:

- a) 2 626 734 455 (dy miliardë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë milionë e shtatëqind tridhjetë e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë) lekë nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë;
- b) 3 899 444 752 (tre miliardë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021.”.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 6201/5
DATË 16.12.2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFOMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjëll Agaci', is written over a circular blue stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKË E SHQIPËS' at the top and 'KESHILLI I MINISTREVE' at the bottom, with a central emblem.